



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

RREGULLORJA DISIPLINORE E FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 11.11.2022

Në bazë të nenit 22 dhe 17 pika 6 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, nenit 27.1 dhe nenit 30.2 të Ligjit të Sportit Nr.2003/24,), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-075, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-115; Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 11.11.2022 miratoi:

RREGULLOREN DISIPLINORE TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet udhëheqja e procedurës disiplinore (në tekstin e mëtejme: procedura) ndaj shkelësve të rregullave të Federatës, Klubeve dhe të organizatave tjera të shenjëtarisë (në tekstin e mëtejme: organizata e shenjëtarisë), kompetencat e komisionit disiplinor, e drejta e lëvizjes së procedurës disiplinore dhe marrja e vendimit, masat disiplinore, ankesa, evidentimi dhe ekzekutimi i masës disiplinore, shlyerja – falja e masës disiplinore, procedura për rastet urgjente të shkeljeve dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare..

Neni 2

Kjo Rregullore ka për qëllim ruajtjen, mirëvajtjen dhe zhvillimin harmonik të sportit të shenjëtarisë në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Kryetarin dhe 2 anëtarët e Komisionit disiplinor si dhe zvendësit e tyre i zgjedh Këshilli drejtues (organi egzekutiv) i FSHSK-se.

Komisioni disiplinor është përgjegjës para organit të vetë që e ka formuar.

Neni 4

Komisioni disiplinor i shenjëtarisë i shqipton masat e caktuara disiplinore ndaj anëtarëve të vetë të caktuara me këtë Rregullore.

Neni 5

Shkelje disiplinore është çdo veprim i anëtarëve të organizatës së shenjëtarisë që është në kundërshtim me dispozitat e Statutit dhe të akteve të përgjithshme të FSHSK-së, të klubeve dhe të organizatave tjera të shenjëtarisë, ose të konkluzioneve dhe të vendimeve të organeve të tyre të bazuara në statut, që dëmtojnë autoritetin e FSHSK-së, dobësojnë disiplinën, dezintegrojnë organizatën e shenjëtarisë, lëndojnë – njollosin autoritetin e personaliteteve të shenjëtarisë, ose në ndonjë mënyrë pengojnë kryerjen e detyrave të organizatave të shenjëtarisë dhe të organeve të tyre.

Komisioni disiplinor shqyrton fletëparaqitjet për shkeljet disiplinore, udhëheqë procedurën disiplinore, të shkeljes së Statutit dhe të rregullave tjera të organizatave të shenjëtarisë, të kryera nga ana e anëtarëve të organizatës së shenjëtarisë dhe shqipton masat disiplinore adekuate brenda kompetencave të veta, e në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

KOMPETENCAT E KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 7

Komisioni disiplinor i organizatës së shenjëtarisë, është i autorizuar për shikimin dhe udhëheqjen e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave adekuate disiplinore për shkelje të rregullave nga ana e anëtarëve të organizatës së shenjëtarisë, e në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Komisioni disiplinor është kompetente për shqyrtimin dhe udhëheqjen e procedurave dhe shqiptimin e masave disiplinore për anëtarët e të gjitha organeve në organizatën e vetë të shenjëtarisë. Komisioni është i autorizuar për marrjen e vendimeve për masa disiplinore për shkelësit disiplinor.

Neni 9

Komisioni disiplinor merr vendime për shqiptimin e masave disiplinore si komision i shkallës së parë. Kundër vendimit të komisionit të shkallës së parë mund të ushtrohet ankesa në Komisionin e Ankesave (si organ ekzekutiv).

Neni 10

Ndërprerja e anëtarësimit në organizatën e shenjëtarisë nuk vlen për humbjen e të drejtës dhe kompetencës komisionit disiplinor si në udhëheqjen e procedurës disiplinore, ashtu edhe për shqiptimin e masave disiplinore për shkeljet që i bëjnë individët në cilësinë e anëtarit të organizatës gjegjëse të shenjëtarisë, nëse shkelja e tillë nuk vjetrohet. Masat e shqiptuara disiplinore personave nga kryerreshti paraprak, fillojnë të rrjedhin nga dita e rianëtarësimit eventual të tij në cilëndo organizatë të shenjëtarisë.

Neni 11

Anëtarët e organizatës së shenjëtarisë, të cilët nuk e paraqesin kryesin e shkeljes disiplinore, fshefin shkeljet e të tjerëve ose pengojnë udhëheqjen e procedurës disiplinore ose mbledhjen e provave, edhe vetë i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore.

Neni 12

Masa disiplinore kundra anëtarit të organizatës së shenjëtarisë nuk mund të shqiptohet pa ofruar mundësinë paraprake, përkatësisht pa e ftuar në bisedë, në të cilën mund të shprehë mbrojtjen e vet.

Nëse personi kundra të cilit është lëvizë procedura disiplinore nuk paraqitet në dy ftesa të rregullta për bisedë, procedura disiplinore vazhdon dhe masa disiplinore do të shqiptohet në bazë të provave të mbledhura me rastin e lëvizjes së procedurës disiplinore.

E DREJTA E LËVIZJES SË PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 13

Procedurën disiplinore e lëvizë Kuvendi, Këshilli drejtues, Komisioni disiplinor dhe organet tjera ekzekutive të organizatave të shenjëtarisë (në tekstin e mëtejme: Organi kompetent).
Procedurën disiplinore e udhëheqë komisioni i organizatës së shenjëtarisë të cekur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje dhe shqipton masën gjegjëse disiplinore.

Neni 14

Organet kompetente të organizatave të shenjëtarisë mund të lëvizin procedurën disiplinore në bazë të:

- padisë së paraqitur me shkrim organit kompetent të organizatës së shenjëtarisë,
- paraqitja me propozim për lëvizjen e procedurës disiplinore e paraqitur nga cilido anëtar i organizatës së shenjëtarisë ose person, në bazë të deklaratës së dhënë për veprat e padrejta dhe shkeljet, dhe
- dijenisë së marr nga personi i tretë për shkeljen e bërë dhe në bazë të deklaratës së ndonjë qytetari.

Neni 15

Procedura disiplinore mund të lëvizet kundra çdo anëtarit të organizatës së shenjëtarisë, pa marrë para sysh funksionin e tij në organet e organizatës së shenjëtarisë.

Neni 16

Procedura disiplinore duhet të kryhet brenda afatit prej 6 muaj nga dita e lëvizjes së procedurës.

Procedura disiplinore ndërpritet:

- nëse nuk është kryer në afatin e caktuar në kryerreshtin 1. të këtij neni,
- nëse gjatë procedurës konstatohet se të dhënat paditëse nuk janë të vërteta,
- në mungesë të argumenteve,
- në rast vdekje të anëtarit të FSHSK-së, kundër të cilit udhëhiqet procedura disiplinore.

Neni 17

Procedura disiplinore vjetrohet pas 1. viti nga dita e lëvizjes, përkatësisht nga dita kur për atë është ditur, nëse në atë afat nuk është lëvizë procedura disiplinore. Nëse për shkeljen dihet pas një viti nga dita e shkeljes së kryer, konsiderohet e vjetruar dhe procedura nuk lëvizet.

Neni 18

Komisioni disiplinor mund të shtyjë udhëheqjen e procedurës, nëse personi kundra të cilit udhëhoqët procedura është i sëmurë, përkatësisht jashtë vendbanimit ose ekzistojnë arsye tjera të cilat i pamundësojnë që ai person të merr pjesë në komisionin disiplinor ose të mbrohet me shkrim.

Shtyrja e udhëheqjes së procedurës nga kryerreshti 1. i këtij neni mund të zgjasë deri në mbarimin e arsyeve që kanë kushtëzuar shtyrjen e procedurës.

LËVIZJA DHE UDHËHEQJA E PROCEDURËS DISIPLINORE DHE MARRJA E VENDIMIT

Neni 19

Fletëparaqitjen për shkelje disiplinore të anëtarit të organizatës së shenjëtarisë e paraqet organizata e shenjëtarisë dhe anëtarët e saj, por mund të paraqet edhe çdo qytetar. Fletëparaqitja bëhet me gojë ose me shkrim te organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë në rreth veprimin e të cilës është bërë shkelja.

Neni 20

Organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë, me marrjen e fletëparaqitjes, e shiqonë atë dhe nëse gjenë se në përshkrimin e veprimit nuk paraqet shkelje disiplinore ose fletëparaqitja është vjetruar, e refuzon dhe për këtë veprim e njofton parashtruesin e fletëparaqitjes.

Vendimin nga kryerreshti paraprak të këtij neni, organi kompetent e merr brenda afatit prej 15 dite.

Nëse fletëparaqitja nuk ka të bëjë për anëtarin për të cilin nuk është kompetent për të shqyrtuar ai komision, të cilit edhe i është drejtuar fletëparaqitja, organi kompetent është i obliguar që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së fletëparaqitjes të ia dërgon organit kompetent të shenjëtarisë.

Neni 21

Nëse në fletëparaqitjen është i përshkruar veprimi, ka të dhëna për shkelje disiplinore dhe ka të bëjë për anëtarin që i takon në kompetencat e komisionit disiplinor të organizatës të cilës edhe i është parashtruar fletëparaqitja, organi kompetent menjëherë merr vendim për lëvizjen e procedurës disiplinore, e më se voni 15 ditë nga dita e marrjes së fletëparaqitjes dhe të njëjtën e procedon deri te komisioni i vet disiplinor.

Vendimin për lëvizjen e procedurës disiplinore organi kompetente e merr në mbledhjen e vetë. Vendimi merret me shkrim dhe i bashkëngjitet lëndës së fletëparaqitjes.

Organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë të cilës i takon komisioni disiplinor, mund të caktojë personin i cili e përfaqëson fletëparaqitjen për shkelje.

Neni 22

Kur organi kompetent i organizatës gjegjëse për lëvizjen e procedurës disiplinore, e merr lëndën nga organi kompetent nga organizata më e lartë e shenjëtarisë, që të lëvizet procedura disiplinore kundër ndonjë anëtari të organizatës së tyre, i njëjti është i obliguar që të merr vendim për lëvizjen e procedurës disiplinore.

Neni 23

Në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit për lëvizjen e procedurës disiplinore komisioni do ti dërgojë ftesë më shkrim (rekomande ose me fletëpranim) anëtarit të organizatës së shenjëtarisë kundër të cilit është lëvizë procedura.

Në ftesë shënohet data, koha dhe vendi i udhëheqjes së shqyrtimit, si dhe përmbajtja e shkurtër e shqyrtimit. Për këtë njoftohet edhe organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë.

Njëkohësisht, komisioni disiplinor do të caktoj një anëtar që ti siguron FSHSKtet me të dhënat e personit kundër të cilit është bërë fletëparaqitja.

Neni 24

Shqyrtimi disiplinor udhëhiqet në përbërje të plotë të komisionit disiplinor. Nëse kjo, për shkaqe të arsyeshme nuk është e mundur, shqyrtimin mund ta bëjnë numër më i vogël i anëtarëve të komisionit disiplinor me atë që nuk mund të jenë më pak se 2 anëtar.

Shqyrtimi është publik. Përjashtimisht nëse këtë e kërkon organizata e shenjëtarisë, kur përcjellja e shqyrtimit nuk është e dëshirueshme të njoftohet opinioni, komisioni disiplinor mund të merr vendim që shqyrtimi të jenë sekret, me atë që vendimi i tillë duhet të mirët para fillimit të shqyrtimit.

Gjatë shqyrtimit, të dhënat në fletëparaqitje dhe mbrojtja e shkelësit dhe të mbrojtësit të tij, deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitë tjera për caktimin e të vërtetës materiale dhe marrjen e vendimit të komisionit, shënohen në procesverbal.

Në fund të shqyrtimit përmbajtja e procesverbalit i njoftohet të paditurit, kurse e nënshkruan Kryetari i komisionit disiplinor dhe Procesmbajtësi.

I padituri ka të drejtë ti paraqet vërejtjet e veta në procesverbal.

Procesverbalet e udhëhequra për shikim disiplinor, si dhe procesverbalet nga shqyrtimi disiplinor me të gjitha materialet dhe vendimin e komisionit disiplinor ruhen 10 vjet dhe evidentohen në libër të veçantë.

Shpenzimet për procedurë disiplinore nuk paguhen.

Neni 25

I pandehuri për shkelje përgjigjet personalisht. I pandehuri mund ta kenë mbrojtësin e vetë, i cili parimisht duhet të jenë nga radhët e organizatës së shenjëtarisë. Shpenzimet e mbrojtësit, nëse ka, i paguan i pandehuri.

Neni 26

Pas kryerjes së shqyrtimit disiplinor, komisioni disiplinor merr Vendim me të cilin i pandehuri i organizatës së shenjëtarisë shpallet fajtor për shkeljet e bëra në detyrë, ishquptohet lloji dhe shkalla e masës disiplinore ose lirohet nga padia.

Neni 27

Komisioni disiplinor do ta lirojë të pandehurin nëse vërtetohet se vepra e bërë nuk paraqet shkelje disiplinore, ose shkelja disiplinore nuk është argumentua ose ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë shkeljen.

Neni 28

Vendimi me shkrim për shqiptimin e masës ndëshkuese, ose për lirim ngafajësia, në afat prej 8 ditësh rekomandë i dërgohet të pandehurit me postë, poste elektronike ose në mënyrë fizike, si dhe organit kompetent të organizatës së shenjëtarisë e cila ka marrë vendim për lëvizjen e procedurës.

Njëkohësisht, për Vendimin e marrë komisioni disiplinor e njofton organin kompetent të organizatës së shenjëtarisë të cilës i takon anëtari të cilit i është shqiptuar masa disiplinore, në mënyrë që të njëjtën të mund të ekzekutoi.

Neni 29

Organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë me rastin e marrjes së vendimit për lëvizjen e procedurës disiplinore, nëse vlerëson se mbetja e të pandehurit në funksionin e vetë me vendimin e komisionit mund të ulë autoritetin e organizatës së shenjëtarisë të dobësojë disiplinën e organizatës ose në një mënyrë e pengon kryerjen e detyrave të organizatës së shenjëtarisë dhe të organeve të sajë, mund të merret vendimi që i pandehuri të suspendohet. Vendimi për suspendim shënohet në procesverbal të organizatës e cila e ka marrë.

Kundër vendimit për suspendim, mund të ushtrohet ankesa organit më të lartë kompetent që e ka marrë vendimin për suspendim dhe atë më se voni në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit për suspendim

Ankesa në vendimin për suspendim nuk e ndalon ekzekutimin e tijë.

MASAT DISIPLINORE

Neni 30

Sipas llojit të shkeljeve disiplinore mund të shqiptohen këto masa disiplinore:

1. Për Shenjëtarin

- a) Vërejtje,
- b) Një ndalim të pjesëmarrjes për një periudhë të caktuar kohe,
- c) Ndalimi I pjesëmarrjes në një numër të caktuar garash,
- d) Ndalim të paraqitjes jashtë vendit,
- e) Përfjashtimi nga FSHSK

2. Për personat përgjegjës, trajnerët, gjyqtarët:

- a) Vërejtje,
- b) Ndalimi i ushtrimit të një funksioni për një kohë të caktuar,
- c) Përfjashtimi nga FSHSK.

3. Për anëtarët:

- a) Vërejtje,
- b) Dënimi me gjobë
- c) Ndalimi I paraqitjes në vend dhe jashtë vendit në afatin e caktuar kohor ose në numrin e caktuar tëgarave.
- d) Përjashtimi nga FSHSK.

VEREJTJA

Neni 31

Dënime me vërejtje shqiptohet për shkeljet disiplinore të cilat janë kryer nën rrethana lehtësuese, në mënyrë që të bëhen më të lehta .

NDALIM NE PJESEMARRJE

Neni 32

Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes mundë të jetë në periudhë të caktuar kohore apo në numrin e caktuar të garave.

Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes në periudhë të caktuar kohore mundë të zbatohet gjerë në dy (2) vite, ndërsa dënimi në mos pjesëmarrjen në një numri të caktuar të garave mundë të zbatohet deri në dhjet (10) gara.

Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes në numrin e caktuar të garave mundë të zëvendësohet në vend të dënimit me ndalim të pjesëmarrjes në periudhën e caktuar kohore gjerë në 10 muaj, me atë të ndalimit të pjesëmarrjes në një (1) garë që I përshtatet me ndalim të pjesëmarrjes në periudhën kohore prej një muajin (1) .

Dënimi kohore me ndalim të pjesëmarrjes si dhe dënimi në ndalim në pjesëmarrje në një numër të caktuar garash mundë të shqiptohet si për garat ekipore ashtu edhe në garat individuale.

Dënimi i ndalimit të pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare nuk mundë të jetë më gjatë se tri vite. Nëse garuesit (Shenjëtari) ose anëtari është I dënuar me ndalim të përfaqësimit ndërkombëtar, dënimi nuk ka të bëjë me pjesëmarrjen në përbërje të përfaqësues Kombëtare.

Dënimi në ndalimin e ushtrimit të funksionit vlen në ndalimin e pjesëmarrjes dhe anasjelltas.

PËRJASHTIMI

Neni 33

Përrjashtimi I garuesit, personit zyrtar, anëtar të Këshillit drejtues në mënyrë automatike, përfshin dënimin e ndalimit të pjesëmarrjes në kohëzgjatje gjerë gjashtë (6) muaj, e cila nuk mundë të zëvendësohet me dënimit të ndalimit për pjesëmarrjen në numrin e caktuar të garave.

NDALIMI NË KRYERJEN E FUNKSIONIT

Neni 34

Dënimi në ndalimin e funksionit mundë të shqiptohet në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh. Personi I dënuar me këtë lloj të dënimit nuk mundë të kryej asnjë funksion në cilën do trup në të cilën është anëtar I Federatës, komisionet, shoqatat, klubeve, të garave, që është anëtar I cilit do trup tjetër gjersa të zgjasë dënimi.

Dënimi I ndalimit në ushtrimin të funksionit përfshin ndalim në pjesëmarrje, edhe të personit të dënuar nëse është garues.

DENIMI ME GJOB

Neni 35

Lartësinë e dënimit me gjobë (në të holla) do ta përcaktojnë anëtarët e Këshillit drejtues. Dënimi në të holla duhet paguar gjerë në afatin 15 prej ditësh prej momentit kur vendimit është bërë i plotfuqishëm.

Vendimit për dënim të cilën e shqipton trupi vepron në kuadër të atij trupi dhe është i efektshëm vetëm brenda atij trupi. Dënimi do të jetë I vlefshëm në kuadër të FSHSK-së, vetëm nëse propozimin e anëtarit e ka vërtetuar Komisioni disiplinor I FSHSK-se i shkallës së dytë I cili mundë ta zbus dënimin të cilin e ka nxjer shkalla e parë. Ankesa duhet të dërgohet në afat prej 15 ditësh prej momentit të plotëfuqishmëris së vendimit duke i bashkangjitur të gjitha provat materiale.

SHKELJET INDIVIDUALE

Neni 36

Atletët, anëtarët e FSHSK-se, personat e tyre përgjegjës dhe gjyqtarët mund të ndëshkohen për e shkeljet e kryera të përshkruar në këtë kapitull të Rregullores ose të përcaktuar nga një tjetër akt i FSHSK-se, në përputhje me ligjet në fuqi të Kosovës.

MOS PJESEMARRJA NE GARAT

Neni 37

Nxitja e atletëve që të mos fillojnë ose të largohen nga konkurrenca, dënohet me mos pjesëmarrjen ose ushtrimin (kryerjen) e funksionit, prej tre deri në gjashtë muaj. Atleti i cili nuk fillon ose largohet nga gara, ndëshkohet për mos pjesëmarrje prej tre deri në gjashtë muaj.

PJESEMARRJA JO E RREGULLT

Neni 38

Atlet i cili merr pjesë në gara pa qen i rregulluar statusi i tij i anëtarësimi në FSHSK, ose nuk ka fituar endetë drejtën për pjesëmarrje, nuk disponon me kontrollim mjekësor apo mjeku nuk ja ka lejuar pjesëmarrjen, gjendet në suspedim ose i dënuar –dënohet me paraqitjen prej dy deri në gjashtë muaje, ndersa personi përgjegjës i klubit, trupi tjetër etj, do të dënohet me mos ushtrimin e funksionit prej tre deri në tetë muaj.

MOS ARDHJA NE GARE

Neni 39

Mospjesëmarrja e pajustificuar i një anëtari ose një individ i një ekipi në Kampionat, apo garë individuale apo ekipore për të cilat ata janë paraqitur, është kundërvatje anëtari do të dënohet me dënim me të holla sipas vendimit të FSHSK-se, dhe një atlet, trajner dhe person përgjegjës (zyrtar) dënohet me ndalim të kryerjes së funksionit prej një gjerë në tre muaj.

DHUNA-SULMI FIZIK

Neni 40

Dhuna ose sulmi fizik gjatë ushtrimeve, gjate garës, para ose pas garës, dhe në lidhje me garimin dënohet me ndalim nga tre muaj deri në dy vjet ose duke përjashtuar nga FSHSK. Mbrojtja e nevojshme nga një sulmi fizik dënohet me një ndëshkim më të lehtë nëse nuk ka ardhur gjerë tek pasoja e rëndë.

ORGANIZIMI I DOBET I GARAVE

Neni 41

Dënohet sipas dispozitave të Rregullave të Përgjithshme të Komisionit të garues të FSHSK-se .

SJELLJA E PAHIJSHME SPORTIVE

Neni 42

Sjellja e pahishme sportive dënohet me vërejtje, por në rast të përsëritjes apo në rastin më të rëndë me ndalim të pjesëmarrjes apo në ushtrimin të funksionit prej një gjerë në tre muaj.

Sjellja josportive nënkupton sharje, sjelljet e pa hishme (lëvizjet trupore) kundërshtimi i vendimit apo vendimit të pa përfunduar të gjyqëtarit, delegatit apo përgjegjësit (zyrtarit) tjetër të garave, provokimi i atletit të tij apo kundërshtarit, gjyqëtarit, delegatit apo zyrtarëve përgjegjës në gara apo të shikuesve me fjalë apo gjeste apo cdo sjellje tjetër i cili mundë ta rënoj kredibilitetin apo autoritetin e sportit të FSHSK .

OFENDIMI DHE PERGOJIMI

Neni 43

Ofendimi, përhapja e thashethëmeve të pavërteta për anëtare të tij ose të tjerëve, për atlet të tijë apo atletin e tjetër të klub, personit përgjegjës, gjyqëtarit, trenerit ose organit, është kundërvatje për të ciin atletit, gjyqtarit apo, trenerit apo personit përgjegjës do ti shqiptohet dënimi me ndalim të përfaqësimit gjegjësisht në kryerjen e funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë muaj, klubin ose organin dënim me të holla. Në rastin më të rëndë apo rastin e përsëritjes atleti, gjyqtari, treneri apo personi përgjegjës personi dënohet me ndalim të përfaqësimit gjegjësisht në ushtrimin e funksionit prej gjashtë (6) deri në një vit (1) ndërsa anëtari dënim në të holla sipas vendimit të FSHSK-se.

MOS KRYERJA E OBLIGIMEVE (PERFUNDIMIT TE OBLIGIMEVE)

Neni 44

Mos kryerja apo kryerja me vonesë dhe dorëzimi i raportit të garave, mos pagesa e gjyqëtarve apo delegatit apo të shpenzimeve të tjera të parapara me rregulloren e garave, mos dorëzimi I librezave të anëtarësimit (regjistrimit) të atletëve apo dokumentacionit tjerë delegatit në shikim kur ajo është paraparë me udhëzim, rregullore të garave, mos pagesa e anëtarësimit apo të taksave të tjera për anëtar apo atlet, mos paraqitja apo vonesat në paraqitjen e garave, vështërsimi i punës të organeve apo trupave të tjerë të FSHSK, mos parashtrimi apo vonimi në kryerjen e përgjegjësisë, të dhënave, kuvendit apo të tjera , apo mos kryerja e çdo obligimit të cilat rrjedhin nga rregulloret të organeve (trupave)të FSHSK, është shkelje për të cilin personave përgjegjës I ushtrimit të funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë (6) muaj.

PARAQITJA DHE REGJISTRMI I DHENAVE TE GABUARA

Neni 45

Paraqitja e të dhënave të gabuara në kuvend apo Zyre (të FSHSK-se), dorëzimi I të dhënave të gabuara në zyrën e regjistrimit (Zyra e Sekretarisë së FSHSK-se) është shkelje për atë atlete të cilin personi përgjegjës dënohet me ndalim në ushtrimin e funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë (6) muaj, ndërsa anëtari me dënimi në të holla sipas vendimit të FSHSK-se.

MOS ZBATIMI RREGULLORES TEKNIKE (GARAVE)

Neni 46

Personi përgjegjës, gjyqtar i cili me qëllim (dashje) gabimisht zbaton rregullat teknike të rregullores të garave dënohet me ndalim të ushtrimit të funksionit prej dy (2) muaj gjerë në një vit .

PERDORIMI I PALEJUAR I MJETEVE DHE METODAVE STIMULUESE (DOPING).

Neni 47

Përdorimi i palejuar i mjeteve dhe metodave të palejuara stimuluese (Doping) do të dënohet në përputhje me rregulloren Antidoping të FSHSK-se, ISSF-se dhe KOK-ut.

Neni 48

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së masës disiplinore, mirën para sysh rrethanat nën të cilat është bërë shkalja disiplinore, motivet dhe rrethanat të pandehurit, cilësitë e tija morale dhe të tjera, a janë zbatuar në të kaluarën kundra tij masa tjera disiplinore ose masa tjera si dhe sjellja e tij para komisionit disiplinor.

Neni 49

Parimisht masat disiplinore shqiptohen shkallë-shkallë mvarsisht nga pesha/shkelja. Me rastin e shqyrtimit merret para sysh pikëpamja e përgjegjësisë të kryesit të shkeljes disiplinore.

Në rastet më të rënda, shqiptimin e masës disiplinore, komisioni disiplinor do të kenë parasysh parimet e qëllimit të masës disiplinore edukuese ndaj bërësit të shkeljes disiplinore, si dhe të anëtarëve tjerë të organizatës së shenjëtarisë.

Me rastin e vlerësimit të lartësisë së masës disiplinore, merren parasysh edhe rrethanat lehtësuese varësisht nga shkelja dhe të pasojave që shkaktohen, komisioni disiplinor mund të shqiptoi çdo masë disiplinore.

Te rrethanat e ndjeshme me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, merret para sysh

Raste te lehta:

- sinqeriteti i kryesit të shkeljes disiplinore,
- ndihma komisionit disiplinor për gjetjen e të vërtetës materiale dhe të ngjashme,
- deklaratat e dhënë, pendimi dhe mospërsëritja e shkeljeve, Rastet e rënda:
- pengimi i komisionit disiplinor gjatë sigurimit të dhënave dhe në udhëheqjen e procedurës,
- deklarimi i të dhënave jo të sakta dhe jo të plota,
- mosrespektimi i vërejtjes gjatë seancës,
- Prishja e unitetit në organizatën e shenjëtarisë të cilit do nivel, deklaratave të rrejshme, tentimi i lëndimit të autoritetit të personave udhëheqë me të pavërteta, shpifjet dhe veprimet tjera që kanë për qëllim njollosjen ose fajësimin e dikujt me paramendime.

Neni 50

Masat më të ashpra shqiptohen në rastet e rënda dhe të përsëritjes së shkeljeve disiplinore pa marrë para sysh se në shkeljen paraprake i është shqiptuar masa disiplinore ose nuk i është shqiptuar, si dhe veprimet dezintegruese dhe të qëllimta për uljen e autoritetit ose për fajësime materiale të pa qenë.

ANKESA

Neni 51

Anëtari i organizatës së shenjëtarisë, të cilit i është shqiptuar masa disiplinore, me vendimin e komisionit disiplinor, ka të drejtë ankese duke ju drejtuar Komisionit të Ankesave të organizatës së shenjëtarisë, komisioni i të cilit ia ka shqiptuar masën.

Ankesa nuk shtynë ekzekutimin e vendimit për masën disiplinore.

Kundër vendimit të komisionit disiplinor të drejtë ankese ka edhe organi që ka marrë vendim për lëvizjen e procedurës disiplinore.

Neni 52

Ankesa procedohet në afat prej 8 ditësh prej ditës së marrjes të vendimit për masën disiplinore, dhe këtë nëpërmjet komisionit disiplinor që e ka shqiptuar masën disiplinore.

Neni 53

Komisioni disiplinor që e pranon ankesën, do të dërgon organit kompetent për shqyrtim me arsyetime eventuale plotësuese, kurse organi kompetent do të vlerësoi afatin të paraparë për parashtrimin e ankesës..

Neni 54

Nëse ankesa është paraqitë me kohë te organi kompetent komisioni i të cilit ia ka shqiptuar masën, organi ekzekutiv të njëjtën mund ta hedhë, vërtetoi, ndryshoi ose anuloi, mëvarësisht nga përmbajtja, që përmban shkelja disiplinore dhe rrethanat tjera.

Ankesat e tilla organi ekzekutiv i organizatës së shenjëtarisë i shqyrton në mbledhjen e parë të vetë.

Neni 55

Vendimi i organit ekzekutiv i marr në ankesën është definitiv dhe kundra tij nuk mund të ushtrohet ankesa.

Neni 56

Nëse vendimin për shqiptimin e masës disiplinore e ka marrë komisioni disiplinor i FSHSK-së, për ankesë do të vendosë Komisioni i Ankesave. Vendimi i Komisionit të Ankesave është definitiv dhe kundra tij nuk mund të ushtrohet ankesa.

Neni 57

Vendimi në ankesë mirë në mbledhjen e parë të radhës të organit i cili është kompetent për marrjen e vendimit sipas ankesës.

Me vendimin sipas ankesës ankuesi do të njoftohet në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes. Për vendimin në ankesë njoftohet edhe komisioni disiplinor i cili ia ka shqiptuar masën disiplinore dhe organizata themelore (klubi) të cilit i takon anëtari që e ka paraqitë ankesën.

Neni 58

Masa e shqiptuar disiplinore rrjedh nga dita e marrjes së vendimit fuqiptotë.

Vendimi bëhet i plotfuqishëm me ditën e skadimit të afatit për ankesë, përkatësisht me ditën e marrjes së vendimit definitiv sipas ankesës.

Neni 59

Anëtari i organizatës së shenjëtarisë të cilit i është shqiptuar masa disiplinore definitive, mund të kërkojë përsëritjen e procedurës disiplinore në raste kur vjen deri të dhënat që nuk janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, të cilat sitë tilla mund të ndikojnë në ndryshimin e vendimit disiplinor të marrë.

Lutja për përsëritjen e procedurës i dërgohet komisionit disiplinor i cili e ka shqiptuar masën brenda 6 muajve nga dita kur është shqiptuar masa disiplinore.

Komisioni disiplinor me marrjen e lutjes për përsëritjen e procedurës vlerëson se a duhet apo nuk duhet të përsëritet procedura.

Në rastin kur komisioni disiplinor vlerëson se është e nevojshme që të përsëritet procedura, atëherë merr vendim dhe udhëheqë procedurën sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Në rastin kur komisioni disiplinor vlerëson se nuk ka elemente për përsëritjen e procedurës, atëherë merr vendim me shkrim dhe e njofton paraqitësin e lutjes.

EVIDENTIMI DHE EKZEKUTIMI I MASËS DISIPLINORE

Neni 60

Evidentimi i të gjitha masave disiplinore që i shqipton komisioni disiplinor i një organizate të shenjëtarisë, si dhe për të gjitha masat disiplinore që i zgjedh organi ekzekutiv në shkallën e dytë, ose i ka shqiptuar komisioni disiplinor i organit më të lartë, i udhëheq Komisioni i Ankesave të shenjëtarisë për të gjithë anëtarët e organizatës së vetë.

Neni 61

Të gjitha masat e plotfuqishme disiplinore shënohen në librin »Evidenca për masa disiplinore« të cilën janë të obliguar ta udhëheqin të gjitha organizatat e shenjëtarisë.

Neni 62

Evidencën e anëtarëve të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore e udhëheqë sekretari i organizatës gjegjëse të shenjëtarisë ose kryesi i administratës.

Libri »Evidenca për masa disiplinore« udhëheqin njësoj në të gjitha organizatat e shenjëtarisë dhe përmbajnë këto të dhëna:

- numrin rendor,
- emrin, emrin e babës dhe mbiemrin, lloji dhe lartësia e masës disiplinore (nga – deri),

- cili komision ose organi ekzekutiv e ka shqiptuar,
- vendimi (numri),
- vendimi për shlyerjen e masës disiplinore, dhe
- vërejtja. (shënimi).

Neni 63

Organizatat e shenjëtarisë dhe organet e tyre janë të obliguara që ti ekzekutojnë të gjitha vendimet e masave të plotfuqishme të cilat janë shqiptuar nga ana e komisionit disiplinor, ndaj anëtarëve të organizatës së tyre.

Nëse ndonjë organizatë e shenjëtarisë refuzon të ekzekutojë vendimin e shqiptuar të plotfuqishëm nga ana e komisionit disiplinor kompetent ose organi, atëherë organi kompetent i organizatës së shenjëtarisë, komisioni i të cilës e ka shqiptuar masën e caktuar disiplinore, ndërmer masa tjera të cilat janë paraparë me Statut ose akte tjera të përgjithshme.

FSHIRJA – FALJA E MASËS DISIPLINORE

Neni 64

Nëse është arrit qëllimi i masës disiplinore, atëherë masa mund ti falet.

Neni 65

Masa disiplinore për shkelje të lehta mund të falet dhe këtë:

- sipas lutjes së anëtarit të organizatës së shenjëtarisë të cilit i është shqiptuar,
- sipas propozimit të organit kompetent të organizatës së shenjëtarisë të cilës i takon anëtari të cilit i është shqiptuar masa,
- sipas qëndrimit të organit të organizatës së shenjëtarisë i cili është kompetent për faljen e dënimit, përveç atyre shkeljeve të rënda nga neni 33.

Neni 66

Masat disiplinore, vërejtje, vërejtja e fundit dhe humbja e të drejtës për pjesëmarrje në gara nuk mund të shlyhen para kalimit 6 mujor nga dita e hyrjes në fuqi.

Masa disiplinore, ndalimi i kryerjes çfarëdo funksioni, nuk mund të shlyhet para kalimit të 1. viti prej ditës kur është krye (mbajt).

Masa disiplinore e përjashtimit nga anëtarësia në organizatën e shenjëtarisë, nuk mund të shlyhet para kalimit 2 vite nga dita e shqiptimit të plotfuqishëm.

Neni 67

Të gjitha masat disiplinore, përveç ndërrimit nga funksioni dhe ndalesa e ushtrimit të çfarëdo funksioni dhe masa disiplinore e përjashtimit, shlyhen pas 3 vitevedhe konsiderohen sikur nuk janë shqiptuar.

Neni 68

Fshirja e masës disiplinore konsiderohet sikur edhe nuk është shqiptuar dhe nuk mund të mirrë si rrethanë e ngarkuar në rast të marrjes së vendimit për masa disiplinore për rastin e shkeljes së përsëritur disiplinore.

Neni 69

Vendimin për falje të masës disiplinore nën kushtet e përshkruara në nenin 49 të kësaj Rregulloreje, e merr organi kompetent, komisioni i të cilit e ka shqiptuar masën disiplinore.

Vendimi i organit kompetent për refuzimin e lutjes ose propozimit për falje – shlyerje është definitive.

Neni 70

Masat sipas procedurës së shkurtuar, të parapara në Rregulloren e garave, mund të merr Këshilli organizativ, përkatësisht organi i tij.

Neni 71

Nën »Procedurë të shkurtuar« konsiderohet marrja e vendimit për shkelje të pamjes (qëndrimin) të bërë në poligon gjatë kohës së gjuajtjes, në prezencën e së paku tre anëtarëve të organizatës së shenjëtarisë, të anëtarit të komisionit disiplinor ose të anëtarit të Këshillit drejtues të FSHSK-së.

Neni 72

Vendimi i Këshillit organizativ, përkatësisht të trupave të tij është definitiv

Neni 73

Masat për shkelje të bëra në gara është përshkruar në Rregulloren e veçantë për gara.

Neni 74

Vendimet që i merr Këshilli organizativ nuk evidentohen në librin »Evidentimi i masave disiplinore« të cilin e udhëheqin organizatat e shenjëtarisë, mirëpo shkeljet e tilla mund të jenë shkas dhe bazë për lëvizjen e procedurës disiplinore.

Neni 75

Për rastet e shkaktimit të dëmit me dashje ose padashje që e shkaktojnë anëtarët e organizatës së shenjëtarisë, vendimi për kompensim i dërgohet organit kompetent të organizatës së tij të shenjëtarisë.

Nëse anëtari i organizatës nuk pajtohet që të paguaj dëmin që e ka shkaktuar me qëllim ose për shkak të pakujdesisë, organi kompetent i organizatës së tij të shenjëtarisë është i obliguar që të paraqes për vendosje gjyqit përkatës.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 76

Për shkeljet disiplinore të shkaktuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, dhe nuk janë shqyrtuar, do të shqyrtohen sipas dispozitave të kësaj Rregullorje.

Neni 77

Komentet në këtë Rregullore i jep Këshilli drejtues i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës.

Neni 78

Kjo Rregullore është aprovuar në mbledhjen e KD të FSHSK-së më 11.11.2022, dhe hynë në fuqi ditën e aprovimit.

Prishtinë, 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli

